



DAVOS 4

Projektet për varfërinë, Berisha takon muzikantin britanik, Bono

OPINION 11

Ktheni vështrimin nga të përndjekurit politikë

Nga Reshat Kripa



Fjalori i 10
ENZO BIAGI

“Belle Époque”

TEMA

E DIEL - E HËNË 27 JANAR 2008
WWW.TEMA.AL

50
LEKË

Gazetë e përditshme
Numër 2264 | Viti VII




GARA RAMA-META NË BAZË

Meta sfidon “Dialog me Shqipërinë”, nis bisedimin me elektoratin e majtë

Kryetari i LSI takohet me pensionistët korçarë, ku paraqiti projektligjin për moshën e tretë

ËSHTË PARË QARTË në media javët e fundit gara e krerëve të dy partive kryesore të opozitës, Rama e Meta, për të qenë protagonistë të së majtës në zhvillimet e fundit politike. Në procesin e bashkëpunimit me mazhorancën për reformën në drejtësi, prej afro dy javësh janë shfaqur platforma të ndryshme të dy partive, të paraqitura nga dy drejtuesit, Rama e Meta. Sapo Rama paraqiti një rezolutë bashkëpunimi për reformën në drejtësi, Meta nxitoi të propozojë një plan veprimi për këtë çështje, që u pasua nga një propozim i Ramës për një pakt kombëtar për reformën në drejtësi. Por duket se këtë garë e ka fituar kreu socialist, pasi rezoluta që ai propozoi për bashkëpunimin për reformën në drejtësi, u miratua në Kuvend nga të gjitha partitë politike. Nëse mund të thuhet se është përcaktuar “fituesi” i garës së protagonistit të partive të majta për reformën në drejtësi, gara për bashkëbisedimin me popullin sapo ka nisur. Tani për tani, gara është e qetë, por nisur nga përvoja, duke u afruar drejt zgjedhjeve parlamentare, pritet që gara të ashpërsohet, pasi shanset që PS dhe LSI të jenë të bashkuara në zgjedhjet e ardhshme duket se janë të pakta.

KAPITULLI IV I LIBRIT TË PUBLICISTIT MERO BAZE Lëvizja anti-Berishë në opozitë



Kryetari i LSI, Ilir Meta, ka nisur bashkëbisedimin me kategori të caktuara, ku dhe është parashikuar të paraqiten projektligje konkrete për kategori, me të cilat do zhvillohen

takimet. Një proces i gjatë bashkëbisedimi me të gjitha kategoritë e shoqërisë shqiptare pritet të vazhdojë përgjatë gjithë këtij viti, i ndarë në tri faza. Takimet me përfaqësues të

moshës së tretë, të identifikuara më shumë si elektorat i PS, japin qartë idenë e një gare ndërmjet PS dhe LSI, për të fituar elektoratin e njëra-tjetrit. Kryetari i LSI, Ilir Meta... ■ 5

EDITORIAL

Kosova e lirë dhe e mosvarme

Hashim Thaçi
Kryeministri i Kosovës

KOSOVA ËSHTË NË PRAG të historisë. Pavarësia është para nesh. Pres nga parlamenti i Kosovës të jetë në gjendje ta deklarojë pavarësinë gjatë ditëve që vijjnë. Ky do të jetë një proces i koordinuar për së afërmi me aleatët tanë, posaçërisht me partnerët tanë nga Bashkimi Evropian dhe SHBA. Prishtina dhe Beogradi kanë kaluar nëpër një periudhë të vështirë të bisedimeve të tendosura. Por një kompromis në lidhje me çështjen më të ndjeshme – pavarësinë – është i pamundur.

Tani, shumica e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB gjithashtu e shohin në këtë mënyrë. Unë javën e kaluar isha në Nju-Jork, ku përsërita angazhimin e Kosovës ndaj procesit ndërkombëtar dhe dëshirën tonë të fortë për të punuar me aleatët tanë në krijimin e kushteve për pavarësinë e Kosovës, e cila së fundi do të ndihmojë forcimin e sigurisë në rajon dhe sigurisë në Evropë. Një Kosovë e pavarur duhet të jetë proces pozitiv.

Ka të tillë që mbesin të bindur se bisedimet duhet të vazhdojnë. Ata janë pakicë. Tani është koha për të lëvizur në fazën e ardhshme, për të lejuar Kosovën, Serbinë dhe regjionin të përfaqojnë dhe të fokusohen në procesin e integritimit evropian.

Përdërisa fjinjët tanë rrisin bashkëpunimin me BE dhe i përmirësojnë standardet ekonomike, Kosova... ■ 10

Komentoni në webfaqen tonë www.tema.al

VIZITA ■ Topi-Thaçi: Pavarësia është çështje ditësh ■ 2-3

KUVENDI ■ Seancë e posaçme më 29 janar për viktimat e Holokaustit ■ 4

KRONIKA ■ Divorcet, katër çifte në ditë zgjidhin martesën ■ 13

PORTRET ■ Ariana Liço, nëna beratase që fali zemrën e të birit ■ 14



INTERVISTA 6-7

Meta: Duhet të përfundojë sa më shpejt rruga Durrës- Kukës

«Shqiptarët dhe grekët janë sa të ngjashëm aq edhe të ndryshëm në kulturat respektive bashkëkohore. Normat dhe vlerat e një kulture nuk mund të gjykojnë në mënyrë arbitrare nga një kulturë tjetër» **Gjekë Marinaj**

Gjekë Marinaj: Shpirtërisht unë jam vendlindja

Intervistë ekskluzive e studiuesit të njohur Gjekë Marinaj, dhënë nga SHBA për "ALBANIA PRESS"

Ramadan Bigza

TË BISEDOSH me një njeri të përmasave të tilla si Gjekë Marinaj, nuk është e lehtë, por njëkohësisht është edhe një kënaqësi e veçantë. Edhe pse një 42-vjeçar, ai është një erudit, që shkon drejtë rritjes së përmasave të tij. Gjatë kohës që jetoj në Shqipëri ai bëri një udhëtim imagjinari midis ëndrrave, por pas viteve 90, ku emigroi në SHBA, Gjekë Marinaj preku realitetin. Falë pasionit për dije ai mbaroi një sërë shkollash, u bë pedagog në Richland College, në SHBA, por nuk harroi pasionin e madh, letërsinë. Librat të tij tashmë janë në dorë të lexuesve. Potencia intelektuale e Gjekë Marinajt tashmë ka dalë jashtë kufijve të SHBA-së. Ai ka marrë pjesë në disa konferenca ndërkombëtare, duke përfshirë atë ALTA ku moderoi shkrimtarët internacional prefsh këtu edhe poetin grek Yiorgos Chouliaras, aktualisht sekretar i shtypit pranë Ambasadës Greke në Washington.

Poezitetë e tij plot ndjenj janë pjesë e formimit të tij të gjithanshëm. Këto dhe cilësi të tjera, që plotësojnë portretin e Gjekë Marinajt kanë bërë që ai të respektohet edhe prej kolegëve duke e ndihmuar atë për themelimin e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro – Amerikanë, në vitin 2001, duke e pranuar atë si President të saj.

Gjekë Marinaj nuk është vetëm një studios i njohur por edhe një bashkëshort i mirë. Ai vazhdon të jetë i tillë, që nga nëntori i vitit 1992, ku siç thotë edhe vetë, u gjeta plotësisht i gatshëm ta kaloj segmentin jetësor nga djalë në burrë.

Por Marinaj edhe pse jeton në vendin e shkencës, që flet me një "gjuhë" të veçantë, nuk e harron vendlindjen. "Nuk mund të harroje Shqipëria më formoi, më bëri njeri. Amerika më dha mundësinë të bëhem një njeri më i ditur. Shpirtërisht unë jam vendlindja, fëmijëria ime. Pa to nuk do të kisha substancën e domosdoshme për të ecur përpara, për t'u kompletuar si njeri dhe si intelektual".

Si e kalon ditën një studiues i njohur si ju?

"Koha për mua është një problem serioz. Tërësia e gjerave që kanë nevojë për vëmendjen time akumulohet përtej mundësisë fizike për t'i kryer

ato me përgjegjësinë që meritojnë. Unë merrem me kohën seriozisht, me shpërfilljen e saj, ashtu siç janë marrë Platon, Augustini, Shekspiri, Elioti, Fraser e shumë e shumë të tjerë para meje. Megjithatë, të tregohem i sinqertë me lexuesin, akoma nuk jam në gjendje ta përcaktoj se çfarë është koha dhe çfarë duhet të bëjmë me të. Ajo që di është se koha ekziston dhe se si fenomen është shumë më e komplikuar se mundësitë që kemi deri tani për ta kuptuar plotësisht atë. Për mua ajo është më shpesh një problem fizik, pra 24 orë në ditë nuk më njaftojnë. Ja një shembull. Në kuptimin social, ne si shoqëri njerëzore kemi rënë dakord që një orë të ketë 60 minuta. Mirëpo, nëse jam i ngjeshur në një trafik rrugor, kur më duhet të jem diku patjetër në një orë të caktuar, koha merr dy kuptime krejt të kundërta për mua. E njëjta kohë, kur është fjala për kohën që kam parashikuar se do më merrte rruga (në kushte normale) dhe koha që kam në dispozicion për të arrit në vendin e dëshiruar, çdo minutë më ngjan se ikën me shpejtësinë e një sekonde. Në të njëjtën kohë, në të njëjtin trafik, koha që kaloi i bllokuar në mes të trafikut më duket se ndalon, më duket se çdo minutë merr një orë për të kaluar. Pra koha papritur më bëhet një problem fizik (nuk pret mua) dhe një problem psikologjik që ecën me kahe të kundërta me nevojat e mia, duke ecur më shpejt se sa duhet në rastin e parë dhe më ngadalë se sa duhet në rastin e dytë. Por, natyrisht, edhe sikur të kisha njohuritë e nevojshme për ta manipuluar, për ta ndaluar sistemin kohor, nuk do e bëja këtë. Sepse koha nuk do të ishte më kohë, ajo do të kthehej në përjetësi. Megjithëse koha ka potencialin e një konflikti serioz shkencor, unë kam gjetur mënyrat e mia të merrem me të. Unë, në lidhje me kohën, gjej komfort tek konkluzionet e mendjeve të ndritura që e kanë studiuar atë. Mendimi i Teilhard de Chardin se koha është kënaqësia e Zotit, është frymëmarrja aktuale e shenjtëritimit, me qetësim sepse gjërat duket të jenë të paraprogramuara për mua. Pra për një gjë që unë nuk jam në kontroll të plotë, nuk ndjej përgjegjësi të njëjtë sikur të isha në kontroll. Elioti, i cili na sugjeron që ta shohim realitetin shpirtëror sikur të jetë në pozicionin 90 gradë të rrotullimit të kohës, më bën që të mendoj se është e pamundur ti kryejmë të gjitha detyrat njerëzore në kohën që kemi në dispozicion. Po ashtu, midis të tjerëve, Platon na mëson të mos merakosemi me kohën,



Gjekë Marinaj

sepse ajo lëviz, dhe çdo gjë që lëvizë nuk e ka gjetur akoma pozicionin e vet—që do të thotë nuk është perfekt. Pra nëse koha nuk është perfekt, as ne nuk mund të jemi plotësisht të tillë. Pra, për arsye kohe (qesh) le ta lëmë e kaq shpjegim rrjedhën e problemeve që kam me të".

Përveç studimeve tuaja në fushën e letërsisë, çfarë ju pëlqen tjetër të bëni?

"Më pëlqen shumë antropologjia dhe fotografia. Kuptohet që mënyra me e mirë e futjes në thellësi të shkencës të së parës dhe të artit të së dytës është udhëtimi për në sa më shumë vende, dhe sa më në thellësi të vendeve të botës. Natyra, pas të cilës jam i pasionuar dhe i dashuruar, është esenca e ekzistencës së tyre. Unë e gjej shumë interesante njohjen nga afër

të origjinës dhe zhvillimin fizik dhe kulturor të njerëzve të ndryshëm.

Dua të di sa më shumë për karakteristikat biologjike, zakonet dhe besimet sociale të tyre. Nuk mund të largohem kurrë nga kurioziteti se cilat janë ngjashmëritë dhe divergencat tona me gjallesat e tjera. Duke ndjekur interesat e mia në studimin e humanëve dhe të punës së tyre zgjeror horizontin rreth natyrës dhe esencës së njerëzimit. Çdo të veçantë, çdo të re që mund të zbuloj unë ose të mund të shoh me sy pasi ta kenë zbuluar studiuesit, kam dëshirë ta fotografoj me aparatim tim qoftë në bardhezi qoftë në formë digjitale. Për mendimin tim, tani më shumë se kurrë ka ardhur koha të mendojmë edhe në mënyrë vizuale. Madje edhe fjalët e konceptet e përgjithshme nganjëherë na e kufizojnë rrjedhën

e përshtypjeve për gjërat e rralla dhe ato të zakonshme.

Fjala vjen, kur e shikojmë një objekt vetëm me syrin e së përgjithshmes apo me atë tipik, shpesh na shpëton objekti në vetvete. Ne tentojmë të udhëtojmë të shohim Pyllin e Shiut, dhe jo një peme të veçantë të tij. Kur jemi në një park botanik tentojmë të shohim lule dhe jo specifiku të këtyre apo atë lule. Kur shikojmë në një vend të huaj tentojmë të shohim njerëz dhe jo një prej tyre sado interesant të paraqitet ai apo ajo. Pra, në një farë mënyre, në kontrast me traditën, të shohësh do të thotë të harrosh aq sa do të thotë të kujtosh. Aparati fotografik më ndihmon si të përqëndrohem në të veçantat e udhëtimeve të mia ashtu edhe për t'i marrë ato me vete për t'u referuar prapë në një kohë tjetër".

